



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 17 Dhjetor 2020

Nr: 38

VENDIM

PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE ZGJEDHORE NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 29, paragrafi 3, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtoi propozimet dhe dokumentacionin e paraqitur;

V Ë R E N

Referuar nenit 29, paragrafi 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton me vendim masën e shpërblimit për punën që kryejnë anëtarët e komisioneve zgjedhore.

Referuar neneve 20 dhe 21, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në mënyrë shteruese, nuk përcaktohet kompetenca për caktimin e masës së shpërblimit të komisionerëve zgjedhorë.

Referuar nenit 19, paragrafi 1, gërma “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.



Data: 23 Dhjetor 2020
Nr: 2535

Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore, vlerëson kohëzgjatjen e funksionimit sipas nivelit të administratës zgjedhore, detyrat, përgjegjësitë dhe ngarkesën e punës sipas funksionit përkatës.

Referuar nenit 28, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) ngrihet 90 ditë para datës së zgjedhjeve dhe do të jetë në detyrë deri në nxjerrjen e tabelës së rezultatit të zgjedhjeve të zonës së administrimit zgjedhor (ZAZ).

KZAZ përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ, duke ushtruar detyra të rëndësishme, ku ndër më kryesore janë emërimi i anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV), shpërndarja e bazës materiale zgjedhore për këto komisione, kontrolli i punës dhe funksionimit të KQV-ve për zhvillimin e rregullt dhe të qetë të procesit të votimit, merr në dorëzim materialet e votimit nga KQV-të, kontrollojnë, drejton procesin e numerimit të votave dhe miraton me vendim tabelën përmbledhëse të rezultateve të zonës së administrimit zgjedhor.

Referuar nenit 36, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KZAZ emëron anëtarët e KQV-së në çdo rast jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve. Anëtarët e KQV-së përgjigjen për zhvillimin e zgjedhjeve në Qendrën e Votimit, duke zbatuar detyrat e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij. Kryetari dhe Sekretari i KQV-së, janë përgjegjës për marrjen në dorëzim nga KZAZ të materialeve zgjedhore para datës së votimit, dhe dorëzimin e materialeve të votimit në Vendin e Numërimit të Votave pas mbylljes së votimit.

Referuar nenit 95, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KZAZ cakton Grupet e Numërimit të Votave (GNV) 10 ditë para datës së zgjedhjeve. Anëtarët e GNV-së kryejnë numërimin, vlerësimin e votave, nxjerrin rezultatin duke plotësuar tabelën e rezultatit për qendrën e votimit të numëruar.

Referuar nenit 179, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, identifikimi elektronik i zgjedhësve do të shtrihet në 100 për qind të votuesve. Përdorimi i teknologjisë së informacionit në zgjedhje, do të shoqërohet me detyra dhe përgjegjësi të shtuara për komisionerët zgjedhorë.



PËR KËTO ARSYE:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 29, paragrafi 3, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Të caktojë masën e shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore që do të ngrihen për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, si më poshtë:
 - a) Kryetarin dhe zv.kryetarin e KZAZ-së në vlerën 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.
 - b) Sekretarin e KZAZ-së në vlerën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.
 - c) Anëtarin e KZAZ-së në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetëmijë) lekë.
 - ç) Për kryetarin e KQV-së në vlerën 5.000 (pesëmijë) lekë.
 - d) Për sekretarin e KQV-së në vlerën 4.500 (katërmijë e pesëqind) lekë.
 - dh) Për anëtarin e KQV-së në vlerën 4.000 (katërmijë) lekë.
 - e) Për anëtarin e GNV-së në vlerën 10.000 (dhjetëmijë) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 23 Dhjetor 2020
Nr. 2585

Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021